



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**  
**Nr. 330, datë 21.06.2023**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË**  
**GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**  
**TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË**  
**SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 12, DATË 18.01.2023,**  
**PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 21.06.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.12 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatja për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,

**VËREN**

**I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET**

1. Me Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20 datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 18.01.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.02.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr. 12, nr. 17 dhe nr. 20 datë 18.01.2023 kandidoi edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja) gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. (aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër).

## II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

4. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 12/2023, dhe 17/2023 dhe 20/2023 mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

5. Me Vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

*“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr.11..; ;nr.24 ..., datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.*

*II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 12. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro; ...”.*

6. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të tij për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 185, datë 25.04.2023, ka vendosur:

*1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr.17 dhe nr. 20 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

7. Ndërkohë, me Vendim nr. 294, datë 30.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 7, 8 dhe 9 të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” Këshilli vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12, nr. 13 dhe nr. 17 u caktua kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi.

8. Më datë 31.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidatja u njoftua për vendimit nr. 294, datë 30.05.2023 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele, ku ajo kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatja nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

### **III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI**

9. Më datë 09.06.2023 nëpërmjet postës elektronike kandidatja znj. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 12 datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3343 prot., datë 12.06.2023, duke parashtruar se: “...bazuar në vendimin nr.12, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, në datë 01.02.2023 kam shprehur interesin për lëvizje paralele pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë (sot Gjykata e shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë). Nëpërmjet kësaj kërkesë paraqes dorëheqjen time nga ky aplikim.”.

10. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky vendim bazuar në pikën 107, Seksioni “D”, Kreun VI të Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” ku përcaktohet se: “Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”; si dhe në pikën 108 Seksioni “DH” dhe në pikën 109 Seksioni “E”. Gjithashtu është mbajtur në konsideratë si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”

11. Në Mbledhjen e datës 12.06.2023 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur për kandidaten znj. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi në procedurën e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023, bazuar në pikën 107, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit nr. 320/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure lëvizjeje paralele për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

### **IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATES**

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

13. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e lëvizjes paralele, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin i ndryshuar, procedura administrative për lëvizjen paralele të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”*. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

14. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 320/2020. Kështu, në Kreun VI, Seksioni D, pika 107, të tij, përcaktohet se: *“Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”*. Gjithashtu është mbajtur në konsideratë dhe pika 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”*

15. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidatja znj. {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga procedura e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të kushteve të tjera ligjore për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidatja u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë lëvizjeje paralele, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t’u tërhequr nga kandidimi.

## **V. KONKLUZIONE**

16. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për

pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidatë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

### **V E N D O S I :**

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**